

	<p style="text-align: center;"><b>Republika e Kosovës</b> <b>Republika Kosova –</b> <b>Republic of Kosovo</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Komuna e Prishtinës</b> Opština Priština –Municipality of Prishtina</p>	<p style="text-align: center;">PRISHTINA</p> 
---	---	--

<b>Datë/a:</b>	15.03.2019
<b>Për/ Za/ To:</b>	NTP “Nuha Bauunternehmum GmbH & Co” & Qamili Gbr “Alba Clean”, Germany”
<b>CC:</b>	Departamenti i Prokurimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Zekë Bardhaj - Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit, Komuna e Prishtinës
<b>Tema/ Subjektat/Subject:</b>	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës



Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1 të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 12.03.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “Nuha Bauunternehmum GmbH & Co.KG” & Qamili Gbr “Alba Clean”, Germany, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Kerkese per Propozime per PPP per Parkingun nentokesor ne Prishtine”, me Nr. të Prok: 616 18 072 512 nxjerr:

## V E N D I M

1. **Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për ri vlerësim e parashtruar nga Operatori Ekonomik “Nuha Bauunternehmum GmbH & Co” & Qamili Gbr “Alba Clean”, Germany, të dt. 12.03.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Kërkese per Propozime per PPP per Parkingun nentokesor ne Prishtine”, me Nr. 616 18 072 512 , kundër Njoftimit për eliminim, të datës 07.03.2019.**
2. **Vërtetohet vendimi i AK i datës: 07.03.2019.**
3. **Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me titull “Kërkese per Propozime per PPP per Parkingun nentokesor ne Prishtine”, me numër 616 18 072 512**
4. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do t’u dorezohet të gjitha palëve te ineteresuara .**

## A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës me datë **19.06.2018** ka publikuar Kërkesen per Kualifikim per: **“PPP per Parkingun nentokesor ne Prishtine”**, me Nr. të Prok: **616 18 072 512**.

Afati i fundit per dorezim te aplikacioneve ishet **24.07.2018**.

Komuna e Prishtinës ka pranuar gjithesejt 6 aplikacione. Nga 6 aplikacuone, jane kualifikuar 4 Operatore Ekonomik, te cileve iu eshte derguar Kerkesa per Propozime me date **29.11.2018**.

Afati i fundit per dorezim te kerkesave per Propozim ishte **05.02.2019**.

Komuna e Prishtinës ka pranuar gjithesejt 2 Propozime.

Me datë 07.03.2019, Autoriteti Kontraktues ka njoftuar OE lidhur me rezultatet e aktivitetit te prokurimit.

Me datë 11.03.2018, Operatorit Ekonomik Nuha Bauunternehmen GmbH & Co” & Qamili Gbr “Alba Clean”, Germany, i është lejuar qasja në dokumentacion.

Operatori Ekonomik **“Nuha Bauunternehmen GmbH & Co” & Qamili Gbr “Alba Clean”, Germany**, me dt. 12.03.2018, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim sipas nenit 108/ A të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), në të cilin pretendon se **Komuna e Prishtinës** ka shkelur **dispozitat e LPP**:

Nenin 6: Ekonomiciteti dhe efikasiteti

Nenin 7: Barazia ne Trajtim/Jo – diskriminimi

Neni 54 Njoftimi i Kandidateve dhe Tenderuesve te eliminuar

Neni 59: Ekzaminimi, vlerësimi dhe Krahasimi i tenderëve

Neni 65: Pranueshmeria e kandidateve dhe tenderuesve

Nenin 72: Dokumentacioni dhe Informacioni shtese

dhe **dispozitat e UOPP**:

Nenin 27: Grupi i Operatoreve Ekonomik

Neni 29: Sigurimi i tenderit

Neni 39: Sqarimi i Tenderëve

Neni 41: Ekzaminimi, vlerësimi dhe Krahasimi i tenderëve

Neni 43: Njoftimi Tenderuesve/kandidatëve

## I. Baza ligjore për refuzim të kërkesës.

Ne lidhje me dispozitat e shkelura te LPP-se për te cilat pretendon "Nuha Bauunternehmum GmbH & Co" & Qamili Gbr "Alba Clean", Germany", Autoriteti Kontraktues sqaron se ka bërë vlerësimin e ofertave ne përputhje te plote me Ligjit për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, dhe njëkohësisht hedhë poshtë te gjitha pretendimet e OE.

1. **Neni 6 i LPP-se (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti)** - sipas këtij neni AK është i obliguar qe te siguroj që fondet publike dhe burimet publike përdoren në mënyrën më ekonomike, gjë te cilën AK e ka respektuar, sepse AK nuk mund te shpall fitues një Propozim i cili **nuk plotëson kushtet e parapara ne Kërkesën për Propozime** me arsyetimin se do te ngel me një oferte te përgjegjshme dhe si rrjedhoje nuk do te ketë konkurrence te mirëfillte. **Konsiderimi i një ofertë te përgjegjshme pa plotësuar kushtet dhe kriteret e parapara ne Dosje te Tenderit përben shkelje te dispozitave te LPP.**

Për me tepër, ua sqarojmë se Komuna e Prishtinës nuk obligohet qe te pranoj çfarëdo propozimi financiar sepse kjo është e sqaruar ne Kërkesën pe propozime ku ceket " *Vlerësimi i Propozimit Financiar do të përfshin shqyrtimin e planit të biznesit sipas parimit "kalorë / dështojë" në kuadër të përshtatshmërisë dhe qëndrueshmërisë financiare të projektit. Komisioni i Vlerësimit rezervon të drejtën të refuzojë çdo biznes plan i cili konsiderohet objektivisht të jetë i paarsyeshëm ose i pa-zbatueshëm. Një prej kriterëve kryesore të vlerësimit të zbatueshmërisë dhe objektivitetit të Biznes Planit do të jetë vlera e IRR. Propozimet Financiare të atyre ofertuesve të cilët kanë marrë rezultat "kalues" gjatë shqyrtimit të Biznes Planit do të vlerësohen".*

**Si rrjedhoje, nga sa u tha me larte Komuna e Prishtinës përfundimisht hedh poshtë pretendimin se ka shkelur Nenin 6 te LPP.**

2. **Neni 7 i LPP-se (Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi)** - sipas këtij neni AK është i obliguar qe do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese, gjë te cilën AK e ka respektuar, duke trajtuar te gjithë OE ne mënyre te barabarte dhe ne te njëjtën kohe thekson se nuk keni dhëne asnjë argument se është shkelur kjo dispozite.

Ne Kërkesën për Propozime, respektivisht ne **Formularin 3.B.1 Detyra Projektuese** ceket: Për projekt ideor ofertuesi duhet së paku të dorëzoj këto dokumente:

1. Situacioni i gjerë 1:1000
2. Situacioni - zgjidhja urbanistike-arkitektonike e projektit 1:500
3. Zgjidhja urbanistike - arkitektonike e projektit me parter 1:200
4. Planimetritë 1:200
5. Prerjet karakteristike 1:200
6. Dukjet (fasadat) 1:200
7. **Detajet karakteristike arkitektonike**
8. Perspektiva e projektit
  - a. Min. 1 ditën
  - b. Min. 1 natën
  - c. Të hapësirave karakteristike
9. Paramasa dhe parallogaria aproksimative (mesatare)
10. Përshkrimi teknik

Poashtu kjo kërkesë është përcaktuar qartë në Detyrën projektuese të kërkesës për propozim(faqe 7):

**Detyra projektuese:**

- Ndërtimi të bëhet në maksimum dy nivele;
- Të ndërtohen minimum 500 vend-parkingje, me një mesatare prej 25 m<sup>2</sup> për parking;
- Mund të ndërtohen objekte afariste por pika më e lartë e ndërtimit është kuota zero dhe vendparkimi duhet patjetër ta ruajë standardin prej mesatarisht 25 m<sup>2</sup>.
- Ndërtimi i Objektiv Afariste nëntokësore: në pjesën e parcelës nga rr. Xh. Bush, lejohet ndërtimi i hapësirës komerciale nën kuotën 0.00, në disnivele ekzistues (maksimum 500m<sup>2</sup>) përderisa lejohet na konfiguracioni i terrenit;
- Duhet të ndërtohen WC publike me qasje të lehtë dhe atë për meshkuj, femra dhe persona me aftësi të kufizuara;
- Duhet të ndërtohet kolektori për rreth tërë vendndodhjes sipas normave teknike për bartjen e infrastrukturës ekzistuese në te.
- Mbi kuotën 0.00 në sipërfaqe duhet të ketë ambiente gjelbërimi duke përfshirë edhe drunjtë të lartë- disa vjeçar.

- Të projektohen elemente mikro-urbanistike siç janë : ndriçimi, ulëset, krojet, fontanat.
- Duhet të sigurohen rrugë lidhëse – shtigje për këmbësorë,
- Duhet të projektohen ambiente për pushim të kalimtarëve, ambiente artistike
- Qasjet për hyrje-dalje të projektohen në pajtim me planet rregulluese që janë në fuqi.

Pra propozimit tuaj i mungojnë “**Detajet karakteristike arkitektonike**” i cili detaj ka qene obligativ qe te dorëzohet dhe siç eshte cekur në Kërkesën për propozim ky vlerësimi është me kalojë / dështojë. **Dëshmi: fq 15 e KPP**

<b>Përmbajtja e projektit (obligative)</b>	<b>PO</b>	<b>JO</b>
Situacioni i gjerë 1:1000		
Situacioni - zgjidhja urbanistike-arkitektonike e projektit 1:500		
Planimetritë 1:200		
Prerjet karakteristike 1:200		
Dukjet (fasadat) 1:200		
Detajet karakteristike arkitektonike		
Perspektiva e projektit (Min. 1 ditën, Min. 1 natën dhe të hapësirave karakteristike)		
Paramasa dhe parallogaria aproksimative (mesatare)		
Përshkrimi teknik		

Si rrjedhoje, konstatohet se elementet mikro urbane si ndriçimi, ulëset, krojet, fontanat duhet të jenë pjesë përmbajtësore e projektit sipas propozimit të kandidatit e jo pjesë e ndonjë negocimi të mëvonshëm dhe nga kjo rezulton se pretendimi juaj për shkeljen e Nenit 7 te LPP refuzohet si i pa bazuar.

3. Neni 54 i LPP-se dhe Neni 45 i UOPP (Njoftimi i Kandidateve dhe Tenderuesve te eliminuar) - sipas këtij neni AK është i obliguar qe do ti informoj OE ne lidhje me rezultatet e një aktiviteti. Komuna e Prishtinës, me email iu ka informuar lidhur me rezultatin dhe ne te njëjtin email iu ka informuar arsyet e eliminimit. Neni 45.2 i UOPP "Përdorimi i formularëve standard" këtu do të thotë se dokumentet e prokurimit duhet të përmbajnë të paktën të gjitha informatat, kërkesat, specifikimet dhe



*kushtet e përcaktuara në formularët standard si informacion të detyrueshëm, dhe në përgjithësi të jenë të qartë dhe të kuptueshme për OE të interesuar". Komuna e Prishtinës iu informon se komunikimi i eliminimit me email është komunikim zyrtar si dhe ju informon se në të njëjtin komunikim është dhënë qartë arsyeja e eliminimit. Gjithashtu ju informon se të drejtat e ofertuesve për tu ankuar janë të paraqitura në fq. 19 të KPP.*

**Dëshmi: fq. 19 e KPP**

*VI.8 Ankesat dhe apelimet - Të drejtat dhe procedurat e përcaktuara në Ligjin Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, në lidhje me ankesat dhe apelimet do të zbatohen pa asnjë kufizim në procesin aktual të prokurimit*

4. **Neni 27 i UOPP (Grupi i Operatoreve Ekonomik)** - në lidhje me pretendimin se për ofertën e Konzorciumit Pessina Construzioni S.P.A. & Jaha Company sh.p.k. & Pesina Gestoni S.R.L., i njëjti person, **Guido Stefanelli**, ka nënshkruar në emër të Pessina Construzioni S.P.A. dhe Pesina Gestoni S.R.L. si CEO, dhe pretendimit se i njëjti person ka konkurruar me dy firma nuk qëndron, sepse i njëjti person nuk ka dorëzuar 2 oferta, por dy firmat janë entitete të ndryshohem ligjore dhe 2 firma kanë hyre në konsorzium dhe se bashku kanë dorëzuar një oferte. Në dëshmitë e dorëzuara nga dy anëtarët e grupit shihet qartë se personi i cekur është përfaqësues zyrtar për të dy kompanitë dhe nuk paraqet kurrfarë konflikti të interesit nënshkrimi për të dy kompanitë. Pretendimi se është shkelur neni 27 i UOPP, respektivisht pika a, b, dhe c nuk qëndron sepse:

*Pika a. Dorëzon një deklaratë të qartë që të gjithë anëtarët e grupit janë së bashku dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e tenderit të grupit, dhe në rast se grupit i jepet kontrata, për performancën e kontratës; - nuk qëndron sepse që të 2 entitetet ligjore kanë konfirmuar se janë së bashku dhe individualisht përgjegjës*

*Pika b. Dorëzon një deklaratë të nënshkruar nga secili nga anëtarët, që konfirmon pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se nuk janë duke marrë pjesë individualisht dhe/ose në grupe tjera në procedurën e njëjtë të prokurimit (deklarata elektronike mund të nënshkruhet duke përdorur nënshkrimin elektronik të avancuar); nuk qëndron sepse që të 2 entitetet ligjore kanë konfirmuar se nuk janë duke konkurruar për të njëjtin aktivitet në ndonjë mënyrë tjetër*

*Pika c. Një deklaratë e nënshkruar nga të gjithë anëtarët të grupit për të autorizuar partnerin udhëheqës të veprave në emër të grupit (deklarata elektronike mund të*

*nënshkruhet duke përdorur nënshkrimin elektronik të avancuar;)* – si dhe te 2 entitetet ligjore kane autorizuar partnerin udhëheqës të veproj në emër të grupit.

Është një parim i pranuar përgjithësisht se kompanitë janë entitete ligjore të ndara edhe nëse pronari është i njëjtë. Nëse do të kishte qenë qëllimi i LPP-së të kërkonte refuzimin e kompanive në pronësi të të njëjtit person atëherë kjo do të ishte një largim nga parimi i lartpërmendur i dhe një dispozitë eksplicite do të përfshihej në ligj në vend që të bazohej në interpretimin analogjik.

Si rrjedhoje, nga sa u tha me larte Komuna e Prishtinës përfundimisht hedh poshtë pretendimin se ka shkelur Nenin 27 te RUOPP.

5. **Neni 72 i LPP-se** (Dokumentacioni dhe Informacioni shtese) – ky nen mundëson qe AK te kërkoj nga OE qe te dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor. Sidoqoftë plotësimi, sqarimi apo kompletimi i dokumentacionit lejohet vetëm dokumentacionin e paraqitur në pajtim me nenet 65-71 te LPP-se, Nene te cilat kane te bëjnë me **“Kërkesat e përshtatshmërisë dhe te kualifikimit”** dhe aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive, e qe ne rastin konkret nuk vlen pasi qe Dokumenti **“detajat arkitektonike”** nuk ndërlidhet me Kërkesat e përshtatshmërisë dhe te kualifikimit dhe ekzistenca e tij nuk është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve.

Dokumenti **“detajat arkitektonike”** nuk mund te kërkohet si sqarim/ plotësim as sipas nenit 59.2 te LPP-se, sepse ky dokument nuk është dorëzuar fare, qe do te thotë nuk ka baze për sqarim dhe neni 59.2 citon se AK mund te kërkoj sqarim shtese për një dokument te dorëzuar por **asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues”**.

Si rrjedhoje, nga sa u tha me larte Komuna e Prishtinës përfundimisht hedh poshtë pretendimin se ka shkelur Nenin 72 te LPP-se.

6. **Neni 29 i UOPP** (Sigurimi i tenderit) – OE pretendon se Komuna e Prishtinës ka shkel ketë nen pasi qe periudha e kërkuar vlefshmërisë se tenderit ne KPP është 120 ndërsa periudha e vlefshmërisë se sigurimit te tenderit do te duhej te ishte per 30 dite me shume, e qe u bie 150 dite. Komuna e Prishtinës hedh poshtë ketë

pretendim dhe sqaron se Komuna e Prishtiens ka vlersar Propozimet vetem ne baze te kërkesave te parashtruara ne KPP.

#### *Ne KPP ceket IV.7 Sigurimi i tenderit*

Ofertuesi do të kërkohet që të vendosë sigurimin e parevokueshëm dhe pa kushte të tenderit në shumën prej **200,000.00 € (dyqind mijë Euro)** ("Sigurimi i Tenderit") për kohëzgjatjen e periudhës së vlefshmërisë të tenderit, siç është përcaktuar në nenin IV.11 të këtij dokumenti.

**Ofertat do të mbesin të vlefshme 120 dite nga afati i dorëzimit të tenderit** i përcaktuar në Kreun IV.1 gjatë periudhës së përmbushjes së kushteve paraprake, siç përcaktohet në kontratën e koncesionit ("Periudha e vlefshmërisë së tenderit").

**Kjo gjithashtu është sqaruar ne Sqarimet shtese #4 ku decidivisht ceket "Vlefshmëria e Sigurimit te tenderit duhet te jete sa periudha e vlefshmërisë se tenderit.** Neni IV.8 përcakton: *Ofertat do të mbesin të vlefshme 120 dite nga afati i dorëzimit të tenderit i përcaktuar në Kreun IV.1 gjatë periudhës së përmbushjes së kushteve paraprake, siç përcaktohet në kontratën e koncesionit ("Periudha e vlefshmërisë së tenderit")... Pra, Sigurimi i tenderit duhet te jete minimum 120 dite nga data e fundit e dorëzimit te propozimeve.* OE ka dorëzuar sigurimin e tenderit te vlefshëm për 125 përderisa kërkesa ka qene minimum 120, dhe si rrjedhojë ka përmbushur kushtin minimal. OE ankues pretendon se është bere shkelje pasi qe Sigurimi i tenderit është i lëshuar ne emër te JAHA Company shpk duke pretenduar se Sigurimi i tenderit , ne rast te konsorciumit, duhet te behet ne emër te udhëheqësit/liderit te grupit. Komuna e Prishtinës sqaron se asnjë dispozite ligjore nuk kërkon qe Sigurimi i tenderit te behet ne emër te liderit te grupit, kur dihet fakti se qëllimi i kërimit te sigurimit te tenderit është qe mjetet te konfiskohen ne rast te mos përmbushjes se detyrimeve nga OE. Kështu qe Komuna e Prishtinës konsideron se nuk është relevante se nga cila xhirollogari do te konfiskohen mjetet, relevante është qe Komuna e Prishtines te konfiskoj mjetet ne rast te shkeljes se dispozitave te përcaktuara.

**Si rrjedhoje, nga sa u tha me larte Komuna e Prishtinës përfundimisht hedh poshtë pretendimin se ka shkelur Nenin 29 te RUOPP.**

7. Neni 59 (Ekzaminimi, vlerësimi dhe Krahasimi i tenderëve) – ky nen kërkon qe "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e



*kontratës dhe në dosjen e tenderit". Komuna e Prishtinës hedh poshtë këtë pretendim duke u bazuar në faktin se ka konsideruar si të përgjegjshme ofertën e cila ka përmbushur të gjitha kushtet e parashtruara në KPP.*

8. Në lidhje me pretendimin e noterizimit të Deklaratës së Përshtatshmërisë dhe kualifikimeve, OE ka dorëzuar 3 Deklarata për secilin anëtar të grupit. Secila deklaratë është e noterizuar nga Noteri Sinan Visoka me nr. të protokollit 937, 938 dhe 939/2019. Që të 3 deklaratat janë nxjerre në të njëjtën ditë 04.02.2019. Komuna e Prishtinës, ka konsideruar si devijim të vogël gabimin teknik të lëshuar nga Noteri, pasi që është e kuptueshme se numri i letërnjoftimi i shënuar është numër italian dhe i njëjti është lëshuar nga organet Italiane e jo siç ceket gabimisht lëshuar nga MPB.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

*Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.*

**Zyrtari përgjegjës i Prokurimit**

---